Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
Nr: 04-353/01-102860
Dt. 13. 10. 2026
P r i z r e n

DREJTORATI PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR KK – PRIZREN, me kërkesën e **Drejtorisë për Shërbime Publike** – Prizren, në bazë të nenit 3 alineja 1 pikat 1.7, 1.17. dhe nenit 5 alineja 1 pika 1.1 neni 14 alineja 1. Pika 1.1 nenin 15 alineja 1 pika 1.1, neni 18 e lidhur me dhe nenin 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim numër 04/L-110, si dhe nenit 17 të Ligjit për Planifikim Hapësinor numër 04/L-174 të dt. 31. 07. 2013, si dhe konform neneve 14, 15, 16, 17 dhe 18 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2017 dt. 23. 05. 2017, e lidhur me nenin 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të neneve 27, 44, 46, 47, 48 si dhe nenit 125 të L.P.P.A. numër 05/031 të datës 25. 05. 2016, si dhe të netit 3 pika 1, neneve 4, 5, 14 dhe 16 të Ligjit Nr. 04/L-066 për Qendrën Historike merr këtë:

A K T V E N D I M

I. **LEJOHET: Drejtorisë për Shërbime Publike** – Prizren me numër të kërkesës **04-353/01-102860** në zhvillimin e punimeve: **Vendosja e Shtatores „Nënë Tereza"** në pjesën e ngastrës kadastrale P-71813068-04869-0 Z.K. Prizren, në rrugën Ismet Jashari.

II. Punëkryesi duhet të përmbahet Vendimit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit-Instituti i Kosoves për Mrojtjen e Monumenteve me nr. **331-2** të datës **21. 09. 2026**, dhe Rekomandimit të Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit të datës **09. 09. 2026.**

III. Dokumentacioni teknik e mban titullin e tipit të veçantë.

IV. Ditën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspekcionin e ndërtimtarisë në afat prej 8 ditësh.

V. Ky aktvendim pushon të vlejë në rast se me punë nuk fillohet brenda afatit prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke llogaritur nga dita e marrjes së të njëjtës.

A r s y e t i m

Nga dokumentacioni teknik si dhe të shtojcave tjera të prezantuara së bashku me kërkesë vërtetohet se: **Drejtorisë për Shërbime Publike** – Prizren me procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.

Duke shqyrtuar kërkesën e investitorit si dhe në kuptim të dispozitave të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për leje, është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes për zhvillimin e punimeve: **Vendosja e Shtatores „Nënë Tereza"** në pjesën e ngastrës kadastrale P-71813068-04869-0 Z.K. Prizren, në rrugën Ismet Jashari.

KËSHILLA UDHËZUESE JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, përmes këtij organi.

Ankesa taksohet me 0,50 € taksa administrative.

Bashkëpunëtor profesional:

Ylber Gashi, inxh. dip. ark.

D R E J T O R I :

Florent Ukaj, eec. dip.